



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”**  
**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Dekani**

Nr. \_\_\_\_Prot,

Shkodër, më 30.07.2018

**N J O F T I M**

Bazuar në Udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2018 – 2019” dhe në Udhëzimin nr. 279 të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, “Për procedurat e regjistrimit të kandidatëve fitues në programet e ciklit të parë për vitin akademik 2018 – 2019” pika 2/a, b, pika 5, njoftojmë të gjithë konkurrentët që kanë aplikuar për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukim Fizik e Sporte, Pikturë - grafikë dhe Pedagogji muzikore, se

1. Konkursset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2018–2019, në Edukim Fizik e Sporte, do të zhvillohet më **22.08.2018** dhe **23.08.2018**.
2. Konkursset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2018–2019, në Pikturë - grafikë dhe Pedagogji muzikore, do të zhvillohen më **17.08.2018** dhe **18.08.2018**.
3. Të gjithë aplikantët që duan të konkurrojnë në programet e studimit në Edukim Fizik e Sporte, duhet të regjistrohen pranë sekretarive mësimore më **datat 15, 16, 17, 18, 20 gusht 2018, nga ora 08<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>**.
4. Të gjithë aplikantët që duan të konkurrojnë në programet e studimit në Pikturë - grafikë dhe Pedagogji muzikore, duhet të regjistrohen pranë sekretarive mësimore më **datat 14, 15, 16 gusht 2018, nga ora 08<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>**.
5. Të gjithë aplikantët që duan të konkurrojnë në programet e studimit në Edukim Fizik e Sporte, Pikturë - grafikë dhe Pedagogji muzikore, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë), në dosje mbahet vetëm fotokopja.
  - 2 (dy) fotografi.
  - Mandatin e pagesës së tarifës me vlerë prej 5 000 lekë (posta shqiptare).
  - Raportin mjeko - ligjor (**vetëm për konkurrentët në programin e studimit Edukim Fizik e Sporte**).

**Dekani**

**Prof. as. dr. Fatmir Vadohej**